



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE			
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIJA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	56
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	02	Data Datum Date:	14, 03, 2016
PRISHTINË/A			

Nr. prot. 56/2016
Datë: 10.03.2016

Në mbështetje të nenit 29 (paragrafi 2, nënparagrafi 2.2) dhe nenit 42 (paragrafi 1) të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 14 (paragrafi 2) të Rregullores Nr. 04/2015 për Procedurat e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave, Mbikëqyrësi Shtetëror, nxjerr:

V E N D I M

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, SHPALLET jo-kompetente për të vendosur lidhur me Ankesën e [redacted] të dt. 26.02.2016 me nr. të prot. 58, dhe për të ndërmarrë veprime të mëtejshme lidhur me Ankesën e këtij subjekti.
2. Pas plotfuqishmërisë së këtij Vendimi, Ankesa bashkë me shtesat e saja mund t'ju drejtohet Institucionit të Avokatit të Popullit i cili është kompetent për Qasja në Dokumente Publike..

A R S Y E T I M

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejshme Agjencia) me datë 26/02/2016 ka pranuar ankesë nga [redacted], lidhur me dhënien e përgjigjeje në pyetjet si në vijim:

1. A konsiderohet dokumenti publik korrespondenca ime interne [redacted] që ka të bëjë me një incident gjatë xhirimit të një TV emisioni?
2. A ka vepruar drejtë zyrtari i Këshillit Prokurorial i Kosovës kur i ka dorëzuar këto letra pa pëlqimin dhe pa dijen time, e me sa duket edhe pa dijen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial.
3. A janë përdorur këto letra në harmoni me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare, respektivisht a ka pasur të drejtë [redacted] që këto letra ti përdor për ushtrimin e padisë private?

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoj Ankesën e lartpërmendur, konstatoj se Ankesa – çështja juridike e personit të lartpërmendur, nuk bien në kompetencë për vendosje të Agjencisë, pasi sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.19) të Ligjit Nr. Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia

është cilësuar si agjencion i pavarur, përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, të definuara me dispozitat e nenit 2 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1) të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e jo përgjegjës për qasje në dokumente publike, si dhe për përgjegjësit disiplinore të nëpunësve civil.

Sipas vlerësimit të Agjencisë, çështja se a janë përdorur këto letra në harmoni me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare është në kompetencë të Institucionit të Avokatit të Popullit i cili është kompetent për Qasje në Dokumente Publike. Ndërsa sa i përket çështjes se a ka vepruar zyrtari i Këshillit Prokurorial i Kosovës kur i ka dorëzuar këto letra pa pëlqimin dhe pa dijen time, e me sa duket edhe pa dijen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial kjo është në kompetencë të komisionit disiplinor ku në përputhje me nenin 70 (paragrafi 1), të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, çdo institucion i administratës publike, i cili punëson nëpunës civilë, themelon një komision disiplinor për marrjen e masave disiplinore në rast të shkeljes së rëndë të Ligjit të Shërbimit Civil apo të akteve nënligjore.

Bazuar në nenin 15 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 04/2015 për Procedurat e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave, Agjencia nuk është përgjegjëse dhe nuk duhet të shqyrtojë një Ankesë nëse është subjekt i një procedure gjyqësore, kështu që për shkaqet e lartpërmendura Agjencia vendosi sikurse në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë Juridike:

Ky Vendim është përfundimtar në procedurë administrative, kurse pala e pakënaqur brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, mund të paraqes padi në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh, për të vërtetuar se shkelja ka ekzistuar.


Ruzhdi Jashari
Mbikëqytës Kryesor Shtetëror

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
-
- Arkivit të Agjencisë